



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

## **KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS SH.A.**

Propozimi për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin e Dytë Relevant të SHTE7

24 dhjetor 2013

## Përmbajtja

1	Hyrje.....	3
2	Struktura e dokumentit.....	3
3	Faktori i efikasitetit .....	4
4	Parimet e llogaritjes së MAR.....	6
4.1	Kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMct) .....	7
4.2	Zhvlerësimi i lejuar (DEPct).....	10
4.3	Kthimi i lejuar në kapital (RTNct).....	11
4.4	Kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill (LGSCt) .....	12
4.5	Kostoja e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFct) .....	14
4.6	Kostot e bartshme (PSTct) .....	15
5	Të Hyrat e parregulluara dhe çështjet e tjera.....	15
5.1	Të hyrat e parregulluara .....	16
5.2	Realizimi i të hyrave të Vitit Relevant 1 .....	16
5.3	Borxhet e kredive Qeveritare.....	16
6	Përmbledhje e propozimeve të KEK-ut për MAR.....	16
I.	Shtojca 1.1: Llogaritja e Kostove të Lejuara të Furnizimit me Thëngjill LGSCt .....	18
II.	Shtojca 1.2: Formularët Raportues .....	22

## 1 Hyrje

Ky dokument paraqet propozimin e Korporatës Energjetike të Kosovës për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për Vitin e dytë Relevant të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE7). Në pajtim me Nenin 5 të Rregullës për Vënien e Çmimeve për Gjeneratorin e Rregulluar (Rregulla), Dokumenti paraqet Përshtatjen e Rregullt të të gjitha kostove të lejuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Shqyrtimin Periodik SHTE7.

Ky Dokument shoqërohet me Formularët e Raportimit për Azhurnimet Vjetore të kërkuara nga ZRRE-ja. Këta formularë kërkojnë paraqitjen e kostove të realizuara për kategori të caktuara të shpenzimeve. Meqë viti për të cilin po raportohet nuk ka përfunduar ende, KEK-u do të kombinojë kostot e realizuara deri më tani me projeksionin e arsyeshëm të kostove që pritet të ndodhin në muajt e mbetur të këtij Viti Relevant. KEK-u potencon se pavarësisht tentimit të vlerësimit sa më të saktë të projeksionit të kostove, kostot e realizuara mund të ndryshojnë në masë të ndjeshme nga vlerat e parashikuara. KEK do ta informojë ZRRE-në lidhur me vlerat finale të kostove të realizuara në momentin që këto kosto realizohen dhe kur vlerat e vitit relevant të jenë përfundimtare.

Vlerësimi i Korporatës Energjetike të Kosovës është se Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin e dytë Relevant të SHTE7 duhet të arrijnë vlerën prej 149.9 milionë euro në mënyrë që KEK-u të jetë në gjendje të mbulojë shpenzimet e arsyeshme të operimit dhe të mirëmbajtjes së rregullt të impianteve energjetike.

## 2 Struktura e dokumentit

Dokumenti është strukturuar si vijon:

- Në seksionin 3 jepet propozimi i KEK-ut për faktorin e aplikueshëm të efikasitetit për Gjeneratorin e Rregulluar;
- Në seksionin 4 është dhënë përshkrimi i legjislacionit që përcakton nivelin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për Divizionin e Gjenerimit;
- Në seksionin 4.1 është dhënë propozimi për komponentin e shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes;
- Në seksionin 4.2 të dokumentit është dhënë propozimi për komponentin e zhvlerësimit;

- Në seksionin 4.3 të dokumentit është dhënë propozimi për komponentin kthimit të lejuar;
- Në seksionin 4.4 të dokumentit është dhënë propozimi për kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill;
- Në seksionin 4.5 të dokumentit është dhënë sqarimi për kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse;
- Në seksionin 4.6 të dokumentit është dhënë llogaritja për kostot e bartshme;
- Në seksionin 5 shqyrtohen të hyrat e parregulluara
- Në seksionin 6 është dhënë një përmbledhje e propozimit të Korporatës Energjetike të Kosovës për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin Relevant;

Krahas të dhënave të dorëzuara në fleta të punës me *Excel*, llogaritjet e dhëna për MAR janë përmbledhur në Shtojcën e këtij Dokumenti.

### **3 Faktori i efikasitetit**

Korporata Energjetike e Kosovës është e vetëdijshme që periudha e Përshtatjeve Vjetore nuk parasheh ndryshimin e Parametrave Rregullativ që kanë ndikim direkt në të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe që janë caktuar gjatë Shqyrtimit Periodik. KEK-u poashtu ka parasysh pritjet e dëshirueshme të rritjes së efikasitetit operativ në Divizionin e Gjenerimit dhe të Minierës por edhe në kompanitë publike në përgjithësi. KEK-u dëshiron të shfrytëzojë këtë mundësi për të reflektuar për përvojat e Vitit të parë Relevant në zbatimin e faktorit të efikasitetit dhe reduktimit të ineficiencës operative.

Gjatë konsultimeve publike në periudhën e Shqyrtimit Periodik, KEK-u ka shprehur brengën se faktori i efikasitetit i caktuar nga ZRRE është vështirë i arritshëm madje edhe në rrethana tërësisht komerciale. Përderisa mekanizmi i rregullimit të çmimeve është i bazuar në idenë e uljes së shpenzimeve për të realizuar profit duke rritur kështu efikasitetin operativ, ky mekanizëm funksionon nën supozimin se ndërmarrja e Rregulluar ka mundësi të kontrollojë të gjitha kostot që i nënshtrohen faktorit të efikasitetit. Disa prej këtyre kostove janë shpenzimet e personelit, reduktimi i kostove të mirëmbajtjes apo ulja e shpenzimeve të tjera që janë të domosdoshme për funksionimin e përditshëm të korporatës si shpenzimet e tjera operative, shpenzimet e zyrës, transportit etj.

Shpenzimet e personelit të KEK-ut janë vështirë të reduktueshme për disa arsye:

- Së pari, pas ndarjes së Divizionit të Furnizimit dhe Shpërndarjes, një pjesë e konsiderueshme e stafit të kualifikuar të KEK-ut – e që është ekspertizë mirë e ndashme në mes të divizioneve – ka kaluar në KEDS. Zëvendësimi i këtij stafi nënkupton punësimin dhe trajnimin e stafit të ri në një sektor që është tejet specifik dhe ku është e vështirë të gjenden kuadra të trajnuara. Kjo vështirësohet edhe më tepër për shkak të pagave mesatare të ulëta të Korporatës Energjetike të Kosovës krahasuar me akterët e tjerë në treg.
- Së dyti, Korporata Energjetike e Kosovës është kompani publike që mban në vete një barrë të rëndë të brengave sociale. Edhe sikur vështirësitë që kanë të bëjnë me mungesën e stafit të kualifikuar profesional të evitoheshin, barra sociale që – me apo pa të drejtë – i alokohet KEK-ut ia bën të vështirë të zbatojë masa rigoroze të rritjes së efikasitetit të personelit. KEK-u është i vetëdijshëm që Rregullat e Çmimeve supozojnë operim komercial të kompanive të rregulluara por ne konsiderojmë që ky problem duhet të merret parasysh nga Rregullatori.

Argumenti për pamundësinë e zvogëlimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes ndërlidhet me vet natyrën e operimit të impianteve energjetike, gjendjen fizike të tyre, teknologjinë e përdorur si dhe mungesën e investimeve sistematike kapitale në të kaluarën. Përmirësimi i disponueshmërisë dhe besueshmërisë së njësive gjeneruese që është parë gjatë viteve të fundit ka ardhur si pasojë e mirëmbajtjes së rregullt të këtyre njësive gjeneruese. Moszbatimi i kësaj praktike do të rrezikonte kthim prapa në sektorin e energjisë, në kohë të daljeve të papritshme të njësive gjeneruese nga funksioni dhe uljes së stabilitetit të operimit të sistemit energjetik.

Për arsyet e përmendura më lart, Korporata Energjetike e Kosovës potencon se nuk është në gjendje të arrijë efikasitetin operacional të caktuar nga ZRRE gjatë Shqyrtimit Periodik. Aplikimi i këtij faktori në Vitin e parë Relevant ka rezultuar në humbje të konsiderueshme financiare në një kohë kur financat e KEK-ut janë vështirësuar edhe më tej si pasojë e reduktimit në të hyra si pasojë e uljes së kthimit në ekuitet nga ZRRE. Për më tepër, mos-aplikimi i faktorit të përshtatjes së të hyrave për Vitin Relevant 1 ka pasur ndikim shtesë negativ në qëndrueshmërinë financiare. Gjendja financiare sa i përket OPMCT-së është përshkruar në Tabelën në vijim:

**Tabela 1** Humbjet në Opex si pasojë e faktorit të efikasitetit

SHTE7 – V1		Mihjet	TC A + TC B
(1) OPMct e lejuar nga ZRRE (4% efikasitet)	€m	40.53	31.70
(2) OPMct e realizuar viti 2013	€m	47.72	29.40
Humbjet (3)=(2)-(1)	€m	(7.19)	2.30
Gjithsejt KEK	€m	(4.89)	

Korporata Energjetike e Kosovës rithekson rëndësinë e rishqyrtimit të faktorit të efikasitetit nga ZRRE për Vitin e dytë Relevant të SHTE7. Ju lutem vëreni se edhe aplikimi i faktorit të efikasitetit prej 0%<sup>1</sup> KEK-u do të realizonte humbje. Duke pasur parasysh kufizimet e KEK-ut për të rritur efikasitetin për shkak të argumenteve të dhëna më lart, konsëiderojmë se aplikimi i faktorit të efikasitetit prej 1% për vit do të ishte i arsyeshëm për KEK-un. MAR-i i llogaritur më poshtë ka marrë për bazë nivelin e efikasitetit prej 1% në OPMct të Gjenerimit dhe të Mihjeve për vitin relevant 2.

#### 4 Parimet e llogaritjes së MAR

Në përgatitjen e propozimit për Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vit in e dytë Relevant të SHTE7, KEK-u ka ndjekur parimet e dhëna në Rregullën për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, që përcakton nivelin e të hyrave të cilat KEK-u mund të mbledhë nga aplikimi i ngarkesave të rregulluara.

Në pajtim me Nenin 5 të Rregullës<sup>2</sup>, në vijim të këtij dokumenti janë llogaritur ndryshimet në të Hyrat Maksimale të Lejuara të përcaktuara gjatë Shqyrtimit Periodik. Këto ndryshime janë llogaritur duke u bazuar në indeksimin e kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes me faktorin e efikasitetit të caktuar nga ZRRE, indeksimin të gjitha kostove të lejuara për të reflektuar inflacionin dhe azhurnimin e kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill. MAR po ashtu është përshtatur për të reflektuar nënmbulimin dhe, në raste të caktuara, mbi-mbulimin e kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill dhe të kostove të tjera që janë jashtë kontrollit të Gjeneratorit të Rregulluar.

<sup>1</sup> OPMct për Divizionin e Mihjeve prej 42.2 milionë euro dhe OPMct për Gjeneratorin e Rregulluar prej 33.0

<sup>2</sup> Rregulla për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar

Të hyrat e propozuara nga Rregullatori, të përmbledhura në pjesën 9 të këtij Dokumenti, kanë përdorur formulat e Shtojcës 1 të Rregullës për të vlerësuar MAR-in që duhet mbuluar nga Ngarkesat e Rregulluara në Vitin e ardhshëm Relevant.

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LGSC_t + OTFC_t + PSTC_t$$

*Ku*

$MAR_t$  paraqet Të hyrat e Lejuara Maksimale në Vitin Relevant  $t$ , të përmbledhura në seksionin 3;

$OPMC_t$  paraqet Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant  $t$ , të përshkruara në seksionin 4.1;

$DEPC_t$  paraqet Zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant  $t$ , të përshkruar në shtojcën 4.2;

$RTNC_t$  paraqet Kthimin e lejuar në kapital në vitin relevant  $t$ , të përshkruar në seksionin 4.3;

$LGSC_t$  paraqet Kostot e lejuara të furnizimit të thëngjillit në vitin relevant  $t$ , të përshkruara në seksionin 4.4;

$OTFC_t$  paraqet Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant  $t$ , të përshkruara në seksionin 4.5;

$PSTC_t$  paraqet Kostot e bartshme në vitin relevant  $t$ , të përshkruara në seksionin 4.6.

#### 4.1 Kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMCt)

Metoda për llogaritjen e kostove të lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes për një vit të caktuar relevant është dhënë në paragrafin 2.1 të Shtojcës 1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar. Rregulla përcakton që kostot e lejuara për operim dhe mirëmbajtje të impiantit në një vit të caktuar relevant të jenë kostot që janë lejuar nga Rregullatori gjatë shqyrtimit periodik të tarifave, të përshtatura për të reflektuar vlerën aktuale të inflacionit në vitin e kaluar, faktorin e efikasitetit të caktuar nga ZRRE-ja për vitin relevant si dhe faktorin profilizues i cili në rastin konkret është caktuar të jetë zero. Formula e dhënë në paragrafin 2.1 të Rregullës është si vijon:

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$$

<i>Ku</i>	
$OPMC_t$	<i>paraqet kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t</i>
$OPMC_{t-1}$	<i>paraqet kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant -t-1, përveç vitit relevant 1, ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik</i>
$CPI_{t-1}$	<i>paraqet Vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, të matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë masë tjetër e inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit për kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që lejohet gjatë shqyrtimit periodik</i>
$E_t$	<i>paraqet Faktorin e efikasitetit në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik dhe i cili është caktuar nga ZRRE të jetë 4%</i>
$P_t$	<i>paraqet Faktorin profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik dhe i cili është caktuar të jetë zero.</i>

Në seksionin 4.1 të dokumentit "Vlerësimi Përfundimtar për Gjenerim" të publikuar nga ZRRE më 22 mars 2013 thuhet se me caktimin e MAR-it gjatë shqyrtimit periodik ZRRE ka aplikuar faktorin e efikasitetit prej 4% për të reflektuar rritjen e pritshme vjetore të efikasitetit të kostove operative dhe të mirëmbajtjes.

Për këtë arsye, llogaritja e ZRRE-së prej €33.0 milionë eurosh është përdorur si bazë mbi të cilën është aplikuar inflacioni i përlllogaritur sipas Shtojcës 1 të Rregullës. Vlera e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit për Eurozonën dhe për të gjitha njësitë është marrë duke iu referuar vlerës së publikuar në ueb-faqen e Eurostat-it.<sup>3</sup> Vlera e inflacionit e përdorur në llogaritjet e përshtatjeve vjetore është ndryshimi në përqindje në mes të muajit më të vonshëm për të cilin ekzistojnë të dhëna në Eurostat ((HICP tetor 2013 / HICP tetor 2012) -1) rezulton të jetë 0.7%.<sup>4</sup>

Megjithatë, gjatë llogaritjes së MAR për Vitin e Parë relevant, ZRRE ka aplikuar faktorin e efikasitetit prej 4% në shumën totale të linjës *Opex (from MAR Model)*<sup>5</sup> që ka përfshirë edhe kostot e furnizimit me lëndë të tjera djegëse (OTFC). Por, sipas Shtojcës 1 të Rregullës, faktori i efikasitetit nuk i aplikohet furnizimit me lëndë të tjera djegëse:

<sup>3</sup> <http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/table.do?tab=table&language=en&pcode=teicp000>

<sup>4</sup> Norma zyrtare e publikuar në ueb-faqen e Eurostat-it llogaritur për Euro zonën (17 shtete) si m/m-12

<sup>5</sup> Linja i referohet Summary Model-it i cili i është dorëzuar KEK-ut nga ZRRE



## Propozimi për të hyrat maksimale të lejuara për vitin 2014

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LGSC_t + OTFC_t + PSTC_t$$

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - Et) * (1 - Pt)$$

$$OTFC_t = OTFC_t + (OTFC_{t-1} - OTFC_{t-1}) * (1 + It)$$

Duke llogaritur faktorin e efikasitetit edhe në formulën e tretë të lartshënuar, ZRRE efektivisht ka zbritur 4% të vlerës së lejuar për Kostot e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFCt) që, sipas ZRRE-së, është 8.3 milionë euro. Kjo vlerë është korrigjuar duke kalkuluar sërish vlerën e OPMCt-së që do të rezultonte sikur efikasiteti të ishte aplikuar sipas Rregullës dhe pastaj kësaj vlere i është shtuar vlera e OTFC-së pa efikasitet. Korrigjimi ka rezultuar rritje të MAR-it të KEK-ut prej 0.4 milionë euro për vitin e kaluar, nëse gjithçka tjetër mbetet e njëjtë.<sup>6</sup> MAR i Vitit të Dytë Relevant është llogaritur duke e përdorur të njëjtin parim por me faktor të efikasitetit prej 1%.

Meqë ZRRE është deklaruar se inflacioni do të llogaritet ex-post, pra në vlerën e lejuar në vitin  $t-1$ , OPMC<sub>t</sub> është llogaritur duke shumëzuar vlerën e HICP me lejesën e OPMC<sub>t</sub> në  $t-1$  dhe kësaj i është shtuar vlera e OPMC<sub>t</sub>-së që është lejuar për vitin relevant  $t$ . Vlera e OPMCt me dhe pa OTFCt dhe diferenca rezultuese është dhënë në tabelën në vijim:

**Tabela 2** Llogaritja e OPMCt pas korrigjimit të OTFCt

		MAR per Gjeneratorin e Rregulluar (KSA+KSB)				
		2013	2014	2015	2016	2017
Faktori profilizues		0.0%	Euribor-i			0.56%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite		0.7%	S-faktori			15.00%
Faktori i efikasitetit		1.0%	I			15.56%
<b>OPMCt</b>		t-1	t	forecast	forecast	forecast
		<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>
OPMCt	€m	33.0	32.7	32.5	32.3	31.1
OTFCt	€m	8.3	8.3	8.3	8.3	7.9
OPMCt-OTFCt plus Efikasiteti dhe inflacioni	€m	24.8	24.5	24.3	24.1	23.2
SHTE7	€m	31.7	31.3	31.0	30.7	29.4
OPMCt korrigjuar	€m	23.8	23.4	23.1	22.9	21.9

<sup>6</sup> Llogaritja supozon që diferenca do të kthehet me të njëjtën normë interesi si korrigjimet e tjera (S-faktori plus EURIBOR).

Komponenta finale e OPMct-së për Vitin e dytë Relevant rezulton do të duhej të ishte 23.4 milionë euro sikur kjo të përdorte të njëjtën mënyrë të llogaritjes si në SHTE7 por pas korrjimit. Pjesa e mbetur që ka të bëjë me OTFct-në i shtohet në Seksionin 4.5 më poshtë.

#### 4.2 Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt)

Sipas paragrafit 2.2 të Shtojcës 1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, zhvlerësimi i lejuar në çdo vit relevant  $t$  duhet të llogaritet duke indeksuar inflacionin në vlerën e zhvlerësimit të lejuar në vitin paraprak  $t-1$ .

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

*Ku:*

$DEPC_t$  Paraqet zhvlerësimin tjetër të lejuar në vitin relevant  $t$ , i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative

$DEPC_{t-1}$  paraqet zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant  $t-1$ , përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullatore

$CPI_{t-1}$  paraqet vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant  $t-1$ , matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i

$P_t$  paraqet faktorin profilizues në vitin relevant  $t$ , i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

Megjithatë, nëse zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant  $t$  ( $DEPC_t$ ) llogaritet duke indeksuar zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant  $t-1$  atëherë shuma e  $MAR_t$  nuk do të arrijë vlerën e lejuar nga ZRRE gjatë shqyrtimit periodik SHTE7. Kjo për shkak se formula e  $DEPC_t$  e dhënë në paragrafin 2.2 të Shtojcës së ZRRE-së supozon që zhvlerësimi do të profilizohet në mënyrë që ai të jetë konstant përgjatë tërë periudhës rregullatore (shih definicionin e  $DEPC_{t-1}$ ). Meqë  $DEPC_t$  dhe  $RTNC_t$  (shih Seksionin 4.3) nuk janë profilizuar gjatë Shqyrtimit Periodik, llogaritja e saktë e  $DEPC_t$ -së për vitin e dytë relevant duhet të llogaritet duke indeksuar për inflacion vlerën e zhvlerësimit në  $DEPC_{t-1}$ , sipas praktikës së ZRRE-së, dhe duke i shtuar kësaj vlerën e lejuar të  $DEPC_t$  të vitit të ardhshëm relevant:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_t =$$

$$13.1 * 0.007 + 14.2 = 14.3 \text{ milionë euro}$$

### 4.3 Kthimi i lejuar në kapital (RTNC<sub>t</sub>)

Kthimi i lejuar në kapital është llogaritur sipas formulës së dhënë në paragrafin 2.3 të Shtojcës 1 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit.

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

*Ku*

*RTNC<sub>t</sub>*            *Është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative*

*RTNC<sub>t-1</sub>*            *Është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullatore*

*CPI<sub>t-1</sub>*            *është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i*

*P<sub>t</sub>*            *është faktori profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik*

Rregulla ka paraparë që DEPC<sub>t</sub> dhe RTNC<sub>t</sub> të profilizohen në mënyrë që të zbuten ndikimet hyrjes në MAR të niveleve të larta të investimeve kapitale. Si në rastin e llogaritjes së zhvlerësimit të lejuar, rregulla specifikon që RTNC<sub>t</sub> të llogaritet duke e indeksuar për inflacion vlerën e RTNC në periudhën t-1. Siç është cekur më lart, kjo formulë supozon se në përcaktimin e RTNC<sub>t</sub>-së në shqyrtimin periodik ZRRE ka aplikuar faktorin e profilizimit në mënyrë që RTNC të jetë konstant për çdo vit relevant t. Meqë RTNC nuk është profilizuar, llogaritja duhet të marrë parasysh indeksimin e inflacionit për lejesën e vitit të kaluar dhe kësaj duhet t'i shtohet kthimi i lejuar për vitin e ardhshëm relevant:

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + RTNC_t =$$

$$= 8.0 * (0.007) + 8.7 = 8.8 \text{ milionë euro}$$

#### **4.4 Kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill (LGSCt)**

Propozimi i Gjeneratorit të Rregulluar për Kostot e Lejuara të Furnizimit me Thëngjill rregullohet me Nenin 11 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar. Propozimi i KEK-ut për këto kosto ndërmerret vetëm për qëllim të përcaktimit të Të Hyrave të Lejuara Maksimale të Divizionit të Gjenerimit dhe nuk paraqet paragjykim për rregullimin e furnizimit me thëngjill nga Rregullatori.

Propozimi për kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill përfshin kostot e taniemës së energjisë dhe i dorëzohet Rregullatorit për shkak se në kohën e hartimit të këtij Dokumenti Gjeneratori i Rregulluar nuk ka marrëveshje për furnizim me thëngjill, në pajtim me Nenin 11 paragrafin 2.2.1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar.

Gjatë llogaritjeve të propozimit të kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill, KEK-u ka përdorur të njëjtat parime si për përcaktimin e MAR-it të Gjeneratorit të Rregulluar, në pajtim me Nenin 11 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar. Kjo llogaritje ka marrë parasysh shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, zhvlerësimin dhe kthimin e lejuar të përcaktuar nga ZRRE gjatë Shqyrtimit Periodik. Kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill janë përshtatur për të përfshirë inflacionin në pajtim me Nenin 11 paragrafin 5 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar.

Tabela në vijim paraqet llogaritjen e LGSCt-së nga KEK-u. Detajet e llogaritjes së kostos së lejuar të furnizimit me thëngjill janë dhënë në Shtojcë të këtij dokumenti.

**Tabela 3** Llogaritja e Kostos së Lejuar të Furnizimit me Thëngjill (LGSCt)

		Kostoja e Lejuar e Furnizimit me Thëngjill (LGSCt)				
		2013	2014	2015	2016	2017
Faktori profilizues		0.0%	Euribor-i			0.56%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite		0.7%	S-faktori			15.00%
Faktori i efikasitetit		1.0%	I			15.56%
<b>OPMct</b>		t-1	t	forecast	forecast	forecast
		<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>
OPMct	€m	42.2	42.0	41.5	41.0	39.4
plus Efikasiteti dhe inflacioni	€m	40.5	<b>40.2</b>	39.5	39.0	37.3
<b>DEPCt</b>		<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>
DEPCt	€m	13.1	14.2	15.8	16.9	17.1
plus inflacioni	€m		<b>14.3</b>	15.9	17.0	17.2
<b>RTNCt</b>		<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>
RTNCt	€m	8.5	9.3	10.7	11.3	10.9
plus inflacioni	€m		<b>9.3</b>	10.7	11.4	11.0
<b>PSTCt</b>						
PSTCt	€m	25.7	25.8	25.9	26.0	23.9
PSTCat-1	€m	24.5				
PSTCat-1 – PSTCft-1	€m	-1.2				
plus interesi	€m		24.4			
<b>LGSCt</b>	<b>€m</b>		<b>88.2</b>			

#### 4.5 Kostoja e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFCt)

Kostot e lëndëve të tjera djegëse të Gjeneratorit të Rregulluar llogariten gjatë përshtatjeve të Rregullta duke marrë parasysh edhe ndryshimin në mes të vlerës së parashikuar dhe asaj të realizuar të OTFC-së për Vitin e kaluar Relevant (t-1). Sipas paragrafit 2.1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, Kostoja e lëndëve të tjera Djegëse në çdo vit relevant t duhet të jetë:

$$OTFC_t = OTFCf_t + (OTFCa_{t-1} - OTFCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

*Ku*

*OTFC<sub>t</sub>* paraqet kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse për Vitin Relevant t

*OTFCa<sub>t-1</sub>* paraqet kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse të realizuara në Vitin Relevant t-1

*OTFCf<sub>t-1</sub>* paraqet kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse të lejuara për Vitin Relevant t-1

*I<sub>t</sub>* paraqet normën e interesit për Periudhën Relevante t, që llogaritet në bazë të EURIBOR-it plus 5% ku S është vlera e caktuar nga Rregullatori gjatë Periudhës Rregullative dhe e cila reflekton preminë që duhet paguar nga i licencuari për kredi afat-shkurtra mbi normën e EURIBOR-it

Siç është përmendur në seksionin 4.1 të këtij Dokumenti, gjatë përcaktimit të MAR në kuadër të Shqyrtimit Periodik, ZRRE ka aplikuar faktorin e efikasitetit në OTFC duke supozuar se kjo është pjesë e OPMct-së së llogaritur më lart. Për të korrigjuar këtë, KEK ka kontaktuar ZRRE-në për të kërkuar informata rreth vlerës së lejuar të OTFCt-së në mënyrë që kjo të ndahet nga OPMct. Vlera e lejuar e OTFCt-së prej 8.3 milionë eurosh për të dy vitet e para relevante është përdorur për llogaritjen e përshtatjes së OTFC-së:

$$OTFC_t = OTFCf_t + (OTFCa_{t-1} - OTFCf_{t-1}) * (1 + I_t) =$$

$$8.3 + (6.4 - 8.3) * (1 + 0.1556) = 6.1 \text{ milionë euro}$$

#### 4.6 Kostot e bartshme (PSTCt)

Kostot e bartshme të Gjeneratorit të Rregulluar paraqesin shumën e kostove të lejuara për shërbimet e operatorit të sistemit dhe të transmisionit si dhe ndryshimin në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara të këtyre kostove për vitin relevant t-1.

Sipas paragrafit 2.6 të shtojcës 1 të Rregullës për vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, kostot e barrshme në çdo Vit Relevant t duhet të jenë:

$$PSTC_t = PSTCf_t + (PSTCa_{t-1} - PSTCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

*Ku*

*PSTC<sub>t</sub>* janë kostot e bartshme në vitin relevant t

*PSTCa<sub>t-1</sub>* janë kostot e bartshme të realizuara në vitin relevant t-1

*PSTCf<sub>t-1</sub>* janë kostot e bartshme të parashikuara për vitin relevant t-1

*I<sub>t</sub>* është norma e interesit për Periudhën Relevante t, që llogaritet në bazë të EURIBOR-it plus 5% ku S është vlera e caktuar nga Rregullatori gjatë Periudhës Rregullative dhe e cila reflekton preminë që duhet paguar nga i licencuari për kredi afat-shkurtra mbi normën e EURIBOR-it

Për llogaritjen e PSTC-së KEK-u ka përdorur vlerat e dhëna në modelin përmbledhës të dërguar nga ZRRE pas përfundimit të shqyrtimit periodik. Meqë kostoja e realizuar e shpenzimeve ndaj KOSTT-it për vitin e parë relevant ka tejkaluar vlerën e lejuar nga ZRRE, përshtatja e PSTC-së rezulton të jetë pozitiv:

$$\begin{aligned} PSTC_t &= PSTCf_t + (PSTCa_{t-1} - PSTCf_{t-1}) * (1 + I_t) = \\ &= 2.6 + (2.9 - 2.4) * (1 + 0.1556) = 3.1 \text{ milionë euro} \end{aligned}$$

## 5 Të Hyrat e parregulluara dhe çështjet e tjera

Llogaritjet e lartshënuara paraqesin llogaritjen e MAR-it për Vitin e ardhshëm Relevant sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar. Sipas paragrafit të parë të Shtojcës 1, formulat e paraqitura kanë për qëllim të plotësojnë parimet e prezantuara në pjesën kryesore të Rregullës. Sa për informim të ZRRE-së, MAR-i i propozuar nga KEK-u nuk përfshin çështjet e listuara në vijim. KEK-u pret që këto çështje të shqyrtohen dhe zgjidhen në ditët në vijim para përcaktimit të të Hyrave Maksimale të Lejuara për Vitin e ardhshëm Relevant.

### **5.1 Të hyrat e parregulluara**

Në praktikë, në të kaluarën, ZRRE ka përshtatur MAR-in e të licencuarve për të reflektuar të ardhurat shtesë që të licencuarit mund t'i përfitojnë në raport me shitjet ndaj palëve të treta. Kjo përshtatje nuk është përfshirë në propozimin e KEK-ut por të dhënat e nevojshme janë dhënë në Formularët Raportues, të cilët i dorëzohen ZRRE-së krahas këtij Raporti.

### **5.2 Realizimi i të hyrave të Vitit Relevant 1**

Siç jeni në dijeni, gjatë Vitit të parë Relevant, Korporata Energjetike e Kosovës nuk ka inkasuar të hyrat maksimale që KEK-ut i janë lejuar në shqyrtimin periodik. Kjo ka ndodhur për shkak të mos-pagesës nga KEDS-i të kostos së plotë të faturave që KEK-u ia ka dërguar për muajin maj. Gjatë takimeve tona të përbashkëta ZRRE ka deklaruar se kjo çështje do të vendoset gjatë përshtatjeve vjetore dhe KEK pret që të merren veprimet e duhura që asnjëra palë të mos dëmtohet financiarisht.

### **5.3 Borxhet e kredive Qeveritare**

Përveç arsyeve të përmendura më lart Korporata Energjetike e Kosovës në Vitin e ardhshëm Relevant rrezikon të operojë në humbje edhe për shkak të pagesave të interesit në kreditë e marra nga Qeveria e Kosovës. Gjatë bisedave me personat relevant të Ministrisë së Financave të cilët na kanë premtuar se interesi gjatë vitit 2012 nuk do të na kërkohet. Mëpastaj ne ju kemi drejtuar me kërkesën tonë Komitetit Ndërmnistror për ndërmarrjet publike për shtyrjen e kthimit të interesit në vitin 2015. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është zotuar që çinteresi i kredive të KEK-ut ta shqyrtojë në Komitetin Ndërmnistror të ndërmarrjeve publike. Ne ende nuk kemi marrë ndonjë vendim nga Komiteti Ndërmnistror lidhur me këtë çështje. Pjesën që është zotuar se do të falet KEK-u tashmë e ka shpenzuar në investime kapitale dhe në mirëmbajtje të stabilimenteve energjetike dhe nuk e ka para të gatshme për pagesë. Fluksi i parasë i gjeneruar nga kthimi i lejuar dhe zhvlerësimi nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar kostot e financimit të investimeve kapitale. Kërkojmë që edhe ky problem të merret parasysh gjatë përcaktimit të të hyrave maksimale të lejuara për Vitin e ardhshëm Relevant.

## **6 Përmbledhje e propozimeve të KEK-ut për MAR**

Sipas formulës së MAR të dhënë në Seksionin 3 të këtij Dokumenti, Të Hyrat Maksimale të Lejuara që janë të nevojshme për operimin normal të KEK-ut, pas aplikimit të faktorit të rreptë të efikasitetit prej 1%, janë 149.9 milionë euro. Llogaritja është dhënë në Tabelën në vijim:



## Propozimi për të hyrat maksimale të lejuara për vitin 2014

**Tabela 4** Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a.

		MAR per Gjeneratorin e Rregulluar (KSA+KSB)				
		2013	2014	2015	2016	2017
Faktori profilizues		0.0%	Euribor-i			0.56%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite		0.7%	S-faktori			15.00%
Faktori i efikasitetit		1.0%	I			15.56%
<b>OPMct</b>		t-1	t	forecast	forecast	forecast
		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
OPMct	€m	33.0	32.7	32.5	32.3	31.1
OTFct	€m	8.3	8.3	8.3	8.3	7.9
OPMct-OTFct	€m	24.8	24.5	24.3	24.1	23.2
plus Efikasiteti dhe inflacioni SHTE7	€m	31.7	<b>31.3</b>	31.0	30.7	29.4
OPMct korrigjuar	€m	23.8	<b>23.4</b>	23.1	22.9	21.9
<b>DEPCt</b>						
		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
DEPCt	€m	21.0	22.2	23.2	24.1	24.5
plus inflacioni	€m		<b>22.3</b>	23.3	24.3	24.7
		*				
<b>RTNct</b>						
		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
RTNct	€m	8.0	8.7	9.2	9.6	9.3
plus inflacioni	€m		<b>8.8</b>	9.3	9.7	9.4
<b>LGSCt</b>						
		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
LGSCt	€m	87.8	88.2	89.0	89.0	83.7
LGSCft-1	€m	87.8				
LGSCat-1	€m	85.6				
plus interesi	€m		<b>85.6</b>			
<b>OTFct</b>						
		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
OTFct	€m	8.3	8.3	8.3	8.3	7.9
OTFctft-1	€m	8.3				
OTFCat-1	€m	6.6				
plus interesi	€m		<b>6.3</b>			
<b>PSTCt</b>						
		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
PSTCt	€m	2.4	2.6			
PSTCft-1	€m	2.4				
PSTCat-1	€m	2.9				
plus interesi	€m		<b>3.1</b>			
<b>MAR korrigjuar</b>		151.3	149.5			
<b>MAR SHTE7</b>		151.0	149.2			
<b>MAR Final</b>		0.3	149.9			

## I. Shtojca 1.1: Llogaritja e Kostove të Lejuara të Furnizimit me Thëngjill LGSCt

Në këtë shtojcë jepen detajet e llogaritjes së kostos së lejuar të furnizimit me thëngjill të cilat, sipas Seksionit 3.4 të këtij Dokumenti, janë vlerësuar të jenë 88.2 milionë euro.

Potencojmë se llogaritja e LGSCt-së bëhet për shkak se në momentin e hartimit të këtij dokumenti nuk ekziston marrëveshje për furnizim me thëngjill në mes të Gjeneratorit të Rregulluar dhe ndonjë ndërmarrje të prodhimit të thëngjillit. Gjatë llogaritjes së LGSCt-së KEK ka supozuar se kompania e mihjeve është kompani normale komerciale. Në llogaritjen e MAR të LGSCt-së, KEK ka supozuar të njëjtat parime si ato të Gjeneratorit të Rregulluar, përveç aplikimit të kostove që mund të jenë specifike për njërin entitet apo për tjetrin.

Ndryshe nga Divizioni i Gjenerimit, në llogaritjen e kostove të lejuara për mihje është përdorur ekuacioni në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + PSTC_t$$

*Ku*

$MAR_t$  paraqet Të hyrat e Lejuara Maksimale në Vitin Relevant  $t$

$OPMC_t$  paraqet Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant  $t$

$DEPC_t$  paraqet Zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant  $t$

$RTNC_t$  paraqet Kthimin e lejuar në kapital në vitin relevant  $t$

$PSTC_t$  paraqet Kostot e bartshme në vitin relevant  $t$

Pra Kostot e lejuara (MARt) janë vlerësuar si shuma e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar gjatë shqyrtimit periodik (pa profilizim) dhe kostove të barrshme (pass-through) në periudhën relevante t.

### Llogaritja e OPMC-së

Llogaritja e shpenzimeve Operative dhe të mirëmbajtjes të divizionit të Mihjeve ka ndjekur të njëjtin parim si në rastin e gjeneratorit të Rregulluar. Vlera e inflacionit është aplikuar në vlerën e OPMCt-së të lejuar në Vitin Relevant t-1, sipas rekomandimeve të ZRRE-së. Vlerës rezultuese i është shtuar vlera e lejuar e OPMCt për vitin relevant t pas aplikimit të faktorit të efikasitetit. Një përjashtim i Mihjeve që

vlen të përmendet është se llogaritja e OPMct-së për Mihje nuk ka pasur nevojë të korrigohet për kostot e lëndëve të tjera djegëse (OTFct) të cilat nuk janë relevante për Mihje. Llogaritja e OPMct-së për Divizionin e mihjeve është dhënë në tabelën në vijim:

**Tabela 5** Kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill e Gjeneratorit të Rregulluar (LGSCt)

	Kostoja e Lejuar e Furnizimit me Thëngjill (LGSCt)					
	2013	2014	2015	2016	2017	
Faktori profilizues	0.0%	Euribor-i			0.56%	
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite	0.7%	S-faktori			15.00%	
Faktori i efikasitetit	1.0%	I			15.56%	
<b>OPMct</b>	t-1	t	forecast	forecast	forecast	
	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	
OPMct	€m	42.2	42.0	41.5	41.0	39.4
plus Efikasiteti dhe inflacioni	€m	40.5	40.2	39.5	39.0	37.3

Llogaritja prej 40.2 milionë eurosh, që është pjesë e LGSCt-së, është llogaritur si vijon:

1. Vlerës së OPMct-së të lejuar për vitin Relevant 1 (42.2 milionë euro) i është aplikuar faktori i efikasitetit (4%);
2. Vlerës rezultuese prej 40.5 milionë eurosh i është shtuar inflacioni;
3. Shumës së vlerës rezultuese nga numri 2 dhe diferencës në mes të OPMct-së në periudhën relevante t dhe t-1 (pa inflacion) i është aplikuar faktori i efikasitetit prej 1%.

$$OPMct = [(42.2 * (1 - 0.04)) * 0.07 + (42.0 - 42.2)] * (1 - 0.01) = 40.2 \text{ milionë euro.}$$

### Llogaritja e DEPCt-së

Zhvlerësimi i lejuar është llogaritur si në rastin e Divizionit të Gjenerimit. Kostoja e lejuar e zhvlerësimit, si në rastin e mëparshëm, nuk është profilizuar siç kërkohet nga Rregulla për Vënien e Çmimeve të Gjenerimit, prandaj kjo ka pamundësuar aplikimin e formulës së Zhvlerësimit në mënyrë strikte:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Aplikimi i kësaj formule në mënyrën e kërkuar nga Rregulla do të rezultonte në LGSCt që nuk është e barabartë me MART-në e supozuar nga ZRRE gjatë shqyrtimit periodik. Prandaj, si në rastin e Gjenerimit,

KEK propozon që llogaritja të bëhet duke aplikuar HICP-në në DEPCt-1 dhe duke i shtuar kësaj vlerën e DEPCt që është lejuar për Vitin e dytë Relevant gjatë Shqyrtimit Periodik. Rezultati i kësaj llogaritjeje është 14.3 milionë euro:

$$\begin{aligned} DEPC_t &= DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_t = \\ &= 13.1 * 0.007 + 14.2 = 14.3 \text{ milionë euro} \end{aligned}$$

### Llogaritja e RTNCt-së

Kostoja e lejuar e kthimit në investime kapitale është llogaritur me të njëjtin parim si ajo e Gjeneratorit të Rregulluar. Meqë RTNCt nuk është profilizuar siç kërkohet në Shtojcën 1 të Rregullës, llogaritja e RTNCt-së ka përdorur të njëjtën metodologji si ajo e DEPCt-së. RTNCt që i shtohet LGSCt-së së Gjeneratorit të Rregulluar rezulton të jetë 9.3 milionë euro.

$$\begin{aligned} RTNC_t &= RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + RTNC_t = \\ &= 8.5 * (0.007) + 9.3 = 9.3 \text{ milionë euro.} \end{aligned}$$

### Llogaritja e PSTCt-së

Kostot e bartshme të Divizionit të Mihjeve përfshijnë kostot e tantimës për thëngjill dhe taksat e licencës. Sipas paragrafit 2.6 të Shtojcës 1 të Rregullës, kostoja e bartshme në çdo Vit Relevant t duhet të marrë parasysh vlerën e parashikuar për atë vit Relevant gjatë Shqyrtimit Periodik por kësaj vlere duhet t'i shtohet diferenca në mes të kostove të bartshme të realizuara në vitin relevant t-1 dhe atyre të lejuara për atë vit relevant:

$$PSTC_t = PSTC_{f_t} + (PSTC_{a_{t-1}} - PSTC_{f_{t-1}}) * (1 + I_t)$$

Llogaritja poashtu ka përdorur normën e interesit  $I_t$ , e cila ka shfrytëzuar S-faktorin e vlerësuar nga ZRRE gjatë Shqyrtimit Periodik (15%) si dhe vlerën e EURIBOR-it për muajin më të vonshëm të vitit 2013 (tetor) prej 0.556%. Meqë kostot e realizuara të bartshme për vitin relevant t rezultojnë të jenë më të ulëta se ato të parashikuara, kjo përshtatje ka rezultuar të jetë 24.4 milionë euro:

$$PSTC_t = 25.8 + (24.5 - 25.7) * (1 + 0.1556) = 24.4 \text{ milionë euro.}$$

Përmbledhje e LGSCt-së

		Kostoja e Lejuar e Furnizimit me Thëngjill (LGSCt)				
		2013	2014	2015	2016	2017
Faktori profilizues		0.0%	Euribor-i			0.56%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite		0.7%	S-faktori			15.00%
Faktori i efikasitetit		1.0%	I			15.56%
<b>OPMct</b>		t-1	t	forecast	forecast	forecast
		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
OPMct	€m	42.2	42.0	41.5	41.0	39.4
plus Efikasiteti dhe inflacioni	€m	40.5	40.2	39.5	39.0	37.3
<b>DEPCt</b>		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
DEPCt	€m	13.1	14.2	15.8	16.9	17.1
plus inflacioni	€m		14.3	15.9	17.0	17.2
<b>RTNCt</b>		<u>2013</u>	<u>2014</u>	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
RTNCt	€m	8.5	9.3	10.7	11.3	10.9
plus inflacioni	€m		9.3	10.7	11.4	11.0
<b>PSTCt</b>						
PSTCt	€m	25.7	25.8	25.9	26.0	23.9
PSTCat-1	€m	24.5				
PSTCat-1 – PSTCft-1	€m	-1.2				
plus interesi	€m		24.4			
<b>LGSCt</b>	<b>€m</b>		<b>88.2</b>			

## II. Shtojca 1.2: Formularët Raportues